



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.2026

V E N D I M

Nr.16, datë 8.06.2026

**PËR
“MIRATIMIN E DOKUMENTIT “UDHËZIM PËR ZBATIMIN E RREGULLAVE TË
INTERNETIT TË HAPUR””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Znj.	Diana Dervishi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 08 qershor 2026, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)” miratuar me vendimin nr. 11, datë 31.03.2026, të Këshillit Drejtues të AKEP me propozim të Drejtorisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Statistikave dhe Inspektimit, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Miratimi i “Udhëzimit për zbatimin e rregullave të internetit të hapur”

BAZA LIGJORE:

1. Pika 4 e nenit 179 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 54/2024)

K Ë SHILLI D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti: Udhëzim “Për zbatimin e rregullave të internetit të hapur”;
2. Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara mbi projektudhëzimin “Për zbatimin e rregullave të internetit të hapur”, të publikuar për këshillim publik;
3. Relacioni shoqërues i Projektvendimit
4. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;

V Ë R E N:

1. Ligji i ri nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i cili hyri në fuqi më datë 20.12.2024, duke shfuqizuar ligjin nr. 9918/2008, të ndryshuar, ka përafruar pjesërisht në legjislacionin kombëtar Direktivën (EU) 2018/1972 të parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike” (në vijim EECC). Përveç transpozimit të EECC, nenet 177-179 të ligjit nr. 54/2024, përcaktojnë kuadrin kombëtar për aksesin në internet të hapur në Shqipëri, të cilat janë hartuar në përfrim të plotë me nenet 3-5 të Rregullores (BE) 2015/2120,¹ që përcaktojnë rregullat për aksesin në internet të hapur të detyrueshme për t’u zbatuar në të gjitha vendet anëtare të BE-së. Pika 4 e nenit 179 të ligjit nr. 54/2024, përcakton se AKEP pas konsultimit me palët e interesuara dhe bazuar në dokumentet përkatëse të BEREC-ut nxjerr udhëzime me qëllim zbatimin e qëndrueshëm të rregullave për internetin e hapur.
2. AKEP, me VKD nr. 3, datë 02.02.2026, ka miratuar për këshillim publik dokumentin “Projekt-Udhëzim për zbatimin e rregullave të internetit të hapur”. AKEP përgatiti dokumentin për këshillim publik “Projekt-Udhëzim për zbatimin e rregullave të internetit të hapur” duke u bazuar në Udhëzimet më të fundit të BEREC mbi Zbatimin e Rregullores për Internetin të Hapur,² si dhe në dokumenta të tjerë të BEREC të referuara në shpjeguesin e dokumentit për këshillim publik (Shtojca 1 e dokumentit të Projekt-Udhëzimit).
3. Projekt-Udhëzimi për zbatimin e rregullave të internetit të hapur, u publikua për konsultim publik në faqen zyrtare të AKEP gjatë periudhës 03.02.2026 - 05.03.2026. Në përfundim të procesit të këshillimit publik, në AKEP, u depozituan komente me shkrim në rrugë zyrtare nga palët e interesuara, si më poshtë:
 - me shkresën nr. me shkresën nr. 425 prot, datë 05.03.2026, administruar në AKEP me nr. prot., 352 datë. 06.03.2026, nga sipërmarrësi “One Albania” sh.a.;

¹ Regulation (EU) 2015/2120 of the European Parliament and of the Council of 25 November 2015 laying down measures concerning open internet access and retail charges for regulated intra-EU communications and amending Directive 2002/22/EC and Regulation (EU) No 531/2012.

² [BoR \(22\) 81 BEREC Guidelines on the Implementation of the Open Internet Regulation, 9 June 2022](#)

- me shkresën nr. LEA/020/LR/EM, administruar në AKEP me nr. prot., 352/1 datë, 06.03.2026, nga sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a.;
 - me shkresën nr.064 prot., datë 5.03.2026, administruar në rrugë elektronike në AKEP, nga sipërmarrësi “Albanian Fiber Telecommunications” sh.p.k (MADCOM).
4. AKEP, pas vlerësimit të komenteve të palëve të interesuara për Projekt-Udhëzimin për zbatimin e rregullave të internetit të hapur, ka përgatitur dokumentat e mëposhtëm:
- a. Dokumentin përfundimtar “Udhëzim për zbatimin e rregullave të internetit të hapur”
 - b. Qëndrimin e AKEP për komentet e palëve të interesuara mbi Projekt- Udhëzim për zbatimin e rregullave të internetit të hapur, të publikuar për këshillimin publik;
5. AKEP në dokumentin “*Udhëzim për zbatimin e rregullave të internetit të hapur*” ka dhënë udhëzime/sqarime të detajura për zbatimin e detyrimeve për internetin e hapur në Shqipëri, duke synuar sigurimin:
- e një interpretimi të unifikuar të neneve 177–179 të ligjit nr. 54/2024 me qëllim zbatim të qëndrueshëm të tyre nga të gjithë ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet (ISP-të);
 - promovimin e disponueshmërisë së vazhdueshme të shërbimeve të aksesit në internet në baza jodiskriminuese dhe në nivele cilësore, që pasqyrojnë përparimet në teknologji;
 - mbrojtje më të mirë të konsumatorëve/përdoruesve fundorë të shërbimit të aksesit në internet;
 - transparencë dhe parashikueshmëri për ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet (ISP-të) në zbatimin e neneve 177-179 të ligjit nr. 54/2024;
 - harmonizim të plotë të zbatimit të rregullave të internetit të hapur në Shqipëri me praktikat më të fundit të BEREC (BoR (22) 81) dhe zbatimin e tyre në vendet e BE-së, si dhe;
 - qasjen dhe planin e AKEP për zbatimin e rregullave të internetit të hapur për disa çështje/aspekte specifike (Shtojca 1 e Udhëzimeve) të lidhura me:
 - specifikimin e shpejtësive minimale, normalisht e disponueshme dhe maksimale të internetit (Neni 178(1/ç));
 - interpretimin për “*mospërputhje e rëndësishme, e vazhdueshme ose e përsëritur rregullisht*” midis shpejtësive të deklaruara të internetit dhe atyre reale/përjetuara nga pajtimtarët/përdoruesit fundorë (neni 178(2/d dhe 3));
 - ofrimin/vënien në dispozicion të publikut nga AKEP të mekanizmit monitorues (i certifikuar) i cilësisë/shpejtësisë së internetit (neni 178(3));
 - publikimin nga AKEP të raporteve periodike në baza vjetore për internetin e hapur, duke filluar nga muaji Qershor 2026 (neni 179(2));
6. Dokumenti “*Udhëzim për zbatimin e rregullave të internetit të hapur*”, në përputhje me pikën 4 të nenit 179 të ligjit 54/2024, është përgatitur pas procesit të këshillimit publik me palët e interesuara si dhe ka marrë parasysh udhëzimet, opinionet, rekomandimet, pozicionet e përbashkëta, praktikat më të mira e metodologjitë e BEREC-ut dhe vendimet përkatëse të Komisionit Evropian, duke u bazuar në Udhëzimet më të fundit të BEREC mbi Zbatimin e

Rregullave për Internetin e Hapur (BoR (22) 81) dhe udhëzime/dokumnta të tjera të BEREC të referuara në dokument në lidhje me zbatimin e rregullave të internetit të hapur në vendet e BE-së, duke i përshtatur me kushtet e tregut dhe fazën e implementimit të këtyre rregullave në Shqipëri;

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë “Udhëzimin për zbatimin e rregullave të internetit të hapur” si dhe “Qëndrimin e AKEP për komentet e palëve të interesuara mbi Projektudhëzimin “Për zbatimin e rregullave të internetit të hapur”, sipas dokumentave bashkëlidhur.
2. Ky Vendim dhe Udhëzimi për zbatimin e rregullave të internetit të hapur, të publikohen në faqen zyrtare të internetit të AKEP: www.akep.al.
3. Ngarkohet administrata e AKEP, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Armer Juka	Bleron Dokle	Diana Dervishi